



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

V E N D I M

Nr. 05, datë 17.10.2025

PËR
MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: “REHABILITIMI NË
EKSTERIER DHE INTERIER I AMBJENTEVE TË GODINËS 1 DHE 2 KATE”,
KUFIZUAR NGA RR. “MIDHI KOSTANI” DHE RR. “MARIGO POZIO”, BASHKIA
KORÇË

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit”, i ndryshuar, me propozim të Ministrisë së Mjedisit, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Rehabilitimi në eksterier dhe interier i ambjenteve të godinës 1 dhe 2 kate”, kufizuar nga Rr. “Midhi Kostani” dhe Rr. “Marigo Pozio”, Bashkia Korçë, me zhvillues Ministrinë e Mjedisit.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave i bashkëlidhen këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet kërkuesit vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
 - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Korçë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyn në fuqi menjëherë.



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I MJEDISIT

Z. SOFJAN JAUPAJ



ANËTAR / SEKRETAR I KKTU-SË

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT



Nënshkruar më datë 23/02 2026